

VENDIM
Nr. 543, datë 29.7.2022

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 315, DATË 31.5.2018, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR MARKAT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 143, 149 , 151/c, 152, 155, 163/a, 163/b, 175/a e 202, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në rregulloren për markat, që i bashkëlidhet vendimit nr. 315 datë 31.5.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

a) Në nenin 15, pas pikës 9 shtohet pika 9.1, me këtë përmbajtje:

“9.1 Zyra do të konsiderojë si ndarje të aplikimit të markës edhe rastet kur një kërkesë për regjistrimin e markës është publikuar me më pak mallra dhe/ose shërbime sesa ka në dëshminë e depozitimit. Zyra pas publikimit të aplikimit fillestar me mallrat dhe/ose shërbimet e munguara në buletinin e PI-së do të vazhdojë procedurat e parashikuara në ligj apo në këtë rregullore për regjistrimin e saj për të gjitha mallrat dhe/ose shërbimet e kërkuara.”;

b) Pas nenit 15 shtohet neni 15/a, me këtë përmbajtje:

“Neni 15/a

Ndarja e një marke të regjistruar

1. Parashikimet e dhëna në pikat 1–7, të nenit 15, të kësaj rregulloreje, gjejnë zbatim edhe për kërkesën e dorëzuar për ndarjen e një marke të regjistruar.

1.1 Formulari i kërkesës për ndarjen e markës së regjistruar, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje, do të përmbajë, gjithashtu, të dhënat e mëposhtme:

1.1.1 numrin e regjistrimit të markës;

1.1.2 emrin dhe adresën e pronarit.

2. Nëse përpara dorëzimit të kërkesës, për ndarjen apo jo të markës së regjistruar, është duke u shqyrtuar një kërkesë për shfuqizim apo pavlefshmëri të markës së regjistruar nga DPPI-ja ose gjykata, vendimmarrja për kërkesën për ndarjen e markës së regjistruar pezullohet, sipas rastit, deri në momentin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me mirëkuptim midis palëve apo marrjes së formës së prerë të vendimit të gjykatës.

Detyrimin për njoftimin e DPPI-së, në lidhje me një kërkesë të depozituar zyrtarisht për shfuqizim apo pavlefshmëri të markës së regjistruar në DPPI apo në gjykatë e ka kërkuesi i shfuqizimit/zhvlerësimit të markës së regjistruar, që kërkohet të ndahet.

3. Markës së ndarë i caktohet një numër i ri kërkesë, si dhe një numër i ri regjistrimi. Marka e ndarë do të ruajë të njëjtën datë depozitimi ose prioriteti, si dhe datë regjistrimi me markën fillestare dhe do të njoftojë pronarin e markës për ndarjen. Njoftimi do të përmbajë ekstraktin e regjistrimit për markën fillestare dhe markën e ndarë.

4. Pas vendimmarrjes së DPPI-së për ndarjen e markës së regjistruar, marka e ndarë nuk do të jetë objekt i publikimit, në kuptim të nenit 151 të ligjit, dhe as kundërshtimit në kuptim të nenit 152 të ligjit.

5. Ndarja e markës së regjistruar do të publikohet në Buletinin Zyrtar.

6. Zyra do të konsiderojë si ndarje të regjistrimit të markës edhe rastet, kur një kërkesë për regjistrimin e markës është:

6.1 publikuar dhe regjistruar me më pak mallra dhe/ose shërbime se sa ka në dëshminë e depozitimit. Zyra pas publikimit të kërkesës fillestare me mallrat dhe/ose shërbimet e munguara

në buletin e PI-së do të vazhdojë procedurat e parashikuara në ligj apo në këtë rregullore për regjistrimin e saj për mallrat dhe/ose shërbimet e munguara.

6.2 publikuar me më pak mallra dhe/ose shërbime nga sa ka në dëshminë e depozitimit dhe regjistruar me të gjitha mallrat dhe/ose shërbimet. Në këtë rast, zyra do të bëjë korrigjimin e certifikatës së markës së regjistruar, dhe, pas publikimit të kërkesës fillestare me mallrat dhe/ose shërbimet e munguara në buletin e PI-së, do të vazhdojë procedurat e parashikuara në ligj apo në këtë rregullore për regjistrimin e saj për këto mallra dhe/ose shërbime.

7. Kërkesa për ndarjen e markës së regjistruar do të jetë sipas formularit që bashkëlidhet këtij vendimi.”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama